

**RAPORT PERIODIK,
 MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHETIT
 DERI MË DATË 31.12.2021**

I. Fondi Rezervë

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

1. Ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën **4 miliardë lekë**, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:

- a) Deri në masën 2 miliardë lekë, për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat 560 milionë lekë për pagesën e naftëtarëve (VKM tashmë e miratuar);
- b) Deri në masën 1 miliardë lekë, për përballimin e kostos së zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare 2021.
- c) Deri në masën 1 miliardë lekë, për hartimin e studim-projektive të investimeve publike strategjike.

2. Me AN nr.4 datë 05.02.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Fondi Rezerve ndryshoi në masën **5 miliard lekë**, ndërkohë që Neni 3, përcakton përdorimin e tij, për:

- a) Raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme në masën 3 miliardë lekë;
- b) Përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021 në masën 1 miliardë lekë;
- c) Për hartimin e studimeve-projektive të investimeve publike strategjike në masën 1 miliardë lekë.

3. Me AN nr.8 datë 22.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar”, Fondi Rezerve mbetet **5 miliard lekë**, por vetëm rishpërndahe sipas Nenit 1:

- a) Raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 4 miliardë lekë;
- b) Përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021 në masën 1 miliardë lekë;
- c) Rezerva për studime-projektive, hiqet.

4. Me AN nr.18, datë 14.04.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar”, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 7 miliardë lekë, ndërkohë që Neni 14, përcakton përdorimin e tij, për:

- a) Raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 6 000 milionë lekë;
- b) Përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, në masën 1 000 milionë lekë;

5. Me AN nr.26 datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar”, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 9 miliardë lekë, ndërkohë që Neni 14, përcakton përdorimin e tij, për:

- a) Raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 8 000 milionë lekë;
- b) Përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, në masën 1 000 milionë lekë;

Deri në datën 31.12.2021, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet 27 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej 7 745.3 milionë lekë, nga 8 miliard lekë të planifikuara ose në rreth 79.4% përqind të planit.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë deri më **31.12.2021** (në milionë lekë)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2021	Miratuar me ligj për vitin 2021	Përdorur me VKM deri 31.12.2021	Mbetur pa përdorur me 31.12.2021	Përqindja (Përdorur/Planifikuar)
	8 000	7 745.3	254.6	96.8%

Nga fondet e miratuara sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave prej 7 745.3 milionë leksh, janë ekzekutuar nëpërmjet shkresave përkatëse, fondet prej 7 732.8 milione lekësh me diferenca në zbatimin VKM-ve si më poshtë:


- ✓ Për VKM nr.453 datë 29.07.2021 "Per disa ndryshime në VKM nr. 826, date 26.10.2020, të KM "Për ofrimin e shërbimeve për pritjen e akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku", fondi i miratuar prej 6 594 mijë lekë për Ministrinë e Brendshme si edhe fondi prej 1 650 mijë lekë për Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Sdhunshëm", nuk janë akorduar, pasi nuk janë paraqitur kërkesat nga institucionet përkatëse.
- ✓ Ndërsa për VKM nr.217 datë 7.04.2021 "Për një shtesë fondi në programin "Mbështetje për Partitë Politike", për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021", fondi i miratuar prej 130 000 mijë lekë është akorduar për 125 817 mijë lekë sipas shkresës përkatëse.

Më konkretisht, nga përdorimi deri më **31.12.2021**, prej 7 732.8 milionë lekë, rezulton se:

- ✓ Rreth 6 995.1 milion lekë ose 87.4 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime korente (shpenzime operative dhe transferata të brendshme);
- ✓ Rreth 737.7 milionë lekë ose 9.2 përqind e planit, janë akorduar për investime.

Grafiku i mëposhtëm paraqet përkatësisht, strukturën e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, deri më 31.12.2021:

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, deri më 31.12.2021 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Ndërsa përdorimi i Fondit Rezervë sipas ministrive dhe institucioneve qendrore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë)

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në % ndaj totalit
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	10	4 236 712	54.7%
10	Ministria Financave dhe Ekonomisë	5	1 485 010	19.2%
03	Kryeministria	1	652 000	8.4%
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	457 000	5.9%
14	Ministria e Drejtësisë	1	209 000	2.7%
15	Ministria e Puneve të Jashtme	1	143 500	1.9%
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2	143 000	1.8%
40	Partitë Politike	1	130 000	1.7%
22	Akademia e Shkencave	1	100 000	1.3%
16	Ministria e Brendshme	3	91 594	1.2%
87	Institucione të tjera Qeveritare	3	76 650	1%
06	Ministria e Energjisë dhe Infrastruktës	1	20 892	0.3%
	TOTALI		7 745 358	100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Në mënyrë analitike rezulton se:

- 4 236.7 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet 10 VKMve, të mëposhtme:
 - ✓ VKM nr. 32, datë 20.01.2021 "Për kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për "Prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer export b.v. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të shëndetit publik", miratuar me ligjin nr. 3, datë 18.01.2021, për shumën 430 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 156, date 10.02.201 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, të miratuar për MSHMS, për Bashkinë Fier", për 35 milionë lekë, për të përballuar shpenzimet për akomodimin e punonjësve që janë angazhuar në ndërtimin e spitalit "Memorial", Fier.
 - ✓ VKM nr. 174, datë 24.03.2021 " Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave, që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilaç Sanayi Ve Ticaret" a.ş.,për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër covid-19 (vero cell) coronavac, të krijuar nga sinovac life science co ltd.dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës", për 1 046 milionë lekë.
 - ✓ VKM nr. 175, datë 17.03.2021 "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit rajonal "Memorial", në Fier si projekt pilot", për 300 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 328, datë 2.06.2021 "Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet "Human vaccine" llc dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë, dhe Institutit të Shëndetit Publik për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën kundër Covid-19 "Sputnik V", të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi". për 55 .5 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 357, datë 16.06.2021" Per kryerjen e pagesës ë dozave të vaksinave që rrjedhin nga marrëveshja midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të shëndetit publik", dhe distributorit te Autorizuar 'Keymenilac Sanyi ve Ticaret A.S", për 1 013.5 milionë lekë.
 - ✓ Nr.490, datë 30.07.2021 "Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave dhe të pagesave respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për prodhimin e furnizimin ndërmjet PfizerExport B.v dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit publik të miratuar me AN nr. 3, date 18.01.2021, të KM" për 298 milionë lekë.
 - ✓ Nr 453, datë 29.07.2021, "Për disa ndryshime në VKm nr. 826, datë 26.10.2020, të KM "Për ofrimin e shërbimeve për pritjen e akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku", për 15.3 milionë lekë.
 - ✓ Nr. 545, date 29.09.2021, "Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave dhe të pagesave respektive, që rrjedhin nga akti normativ nr. 30, datë 27.9.2021, i këshillit të ministrave, "për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet pfizer export b.v. dhe ministrisë së shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale të shqipërisë, ministrit të shtetit për rindërtimin dhe institutit të shëndetit publik, miratuar me AN nr.3 date 18.01.2021", për 629.7 milionë lekë.
 - ✓ Nr. 791, datë 15.12.2021 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit", për 413 658 mijë lekë.
- 1 485 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet 5 VKM-ve, të mëposhtme:
 - ✓ VKM nr. 909, datë 18.11.2020, "Per percaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe të masës së perfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh", për 461.3 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 78, datë 10.02.2021, "Për ekzekutimin e VGJE për të drejtat e njeriut, dt 4.08.2020, për ceshtjen "Tershana kunder Shqiperise", për 1.8 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 208, datë 29.03.2021 "Për dhënie ndihme financiare familjes së dëshmorit të atdheut Arjan Sala", për 1 milion lekë.
 - ✓ VKM nr. 291, datë 19.05.2021, "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për MGFE për financimin e projektit "Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit", për 220.8 milion lekë.

- ✓ *Nr. 577, date 6.10.2021, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për MFE-në për subvencionimin e pagesave të qirasë për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore të tërmetit të datës 26.11.2019", për 800 milionë lekë.*
- 652 milion lekë janë akorduar për Kryeministrinë me VKM-në nr. 747, datë 9.12.2021 " Për financimin e projektit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës "Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme".
- 457 milion lekë janë akorduar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me VKM nr. 135, datë 5.03.2021 "Per disa shtesa dhe ndryshime në vkm nr.73 date 05.02.2021 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për komisionin qendror të zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për kuvend të datës 25 prill 2021", për investime.
- 209 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Drejtësisë "Për disa shtesa në Vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të KM," për shpërblimin e punonjësve të sistemit të burgjeve '.
- 143.5 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Punëve të Jashtme me VKM nr. 224, datë 7.04.2021 "Per miratimin e kontrates me objekt konsulence për hartimin e projektmarreveshjes qe do te lidhet ndermjet RSH dhe asaj te Greqise, per referimin e ceshtjes se kufizimit te zonave detare prane Gjykates nderkombetare te Drejtesise", për 143.5 milion lekë.
- 143 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet dy VKM-ve të mëposhtme:
 - ✓ *VKM nr. 278, datë 12.05.2021 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbështetjen e promovimin të Turizmit Shqiptar në tregjet ndërkombëtare si nevojë për situatën post COVID-19", për 100 milion lekë.*
 - ✓ *VKM nr. 332, datë 2.06.2021 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për MTM, për pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit ICSID case nr. ARB/14/26", për 43 milion lekë.*
- 130 milionë lekë janë akorduar për Partitë Politike me VKM-në nr. 217, datë 7.04.2021 "Për një shtesë fondi në programin "Mbështetje për Partitë Politike", për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021".
- 100 milion lekë janë akorduar për Akademinë e Shkencave me VKM nr. 18, datë 20.01.2021 "Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2021, të miratuar për ASH për financimin e hartimit e botimit të tre veprave madhore albanologjike dhe enciklopedike", për 100 milion lekë.
- 91.5 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Brendshme nëpërmjet tre VKM-ve:
 - ✓ *VKM nr. 453, datë 29.07.2021 "Për disa ndryshime në VKM nr. 826, datë 26.10.2020 "Për ofrimin e shërbimeve për pritjen e akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku" për 6 594 mijë lekë.*
 - ✓ *VKM nr. 547, datë 29.09.2021 "Për dhënie ndihme financiare familjes së nënkomisarit Saimir Hoxha, ish punonjës policie, i vrarë në krye të detyrës", për 5 000 mijëlekë.*
 - ✓ *VKM nr. 859, datë 29.12.2021 "Për disa shtesa në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin e përdorimin e Fondit të veçantë për 80 000 mijë lekë.*
- 76.6 milion lekë janë akorduar për Institucionet e tjera Qeveritare(Gr. 87), nëpërmjet tre VKM-ve të mëposhtme:
 - ✓ *VKM-së nr. 224, datë 7.04.2021 ""Për miratimin e kontratës me objekt konsulencë për hartimin e projektmarreveshjes që do të lidhet ndërmjet RSH dhe asaj të Greqisë, për referimin e çështjes së kufizimit të zonave detare pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë", për 35 milionë lekë.*
 - ✓ *VKM nr 453, date 29.07.2021, "Për disa ndryshime ne VKm nr. 826, date 26.10.2020, te KM "Per ofrimin e sherbimeve per pritjen e akomodimin e femijeve te pashoqeruarte kthyer nga Siria dhe Iraku", për 1,7 milionë lekë.*
 - ✓ *VKM nr. 813, datë 24.12.2021, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Agjencinë për Dialog e Bashkëqeverisje për financimin e programit të këshillimit kombëtar", për 40 milion lekë.*
- 20.8 milion lekë për Ministrinë e Brendshme me VKM nr. 294, datë 19.05.2021 "Për shpronësimin per interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme prone private qe preken nga realizimi i projektit 'ndertimi i spitalit rajonal Memorial Fier", për 20.8 milion lekë.

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 31.12.2021, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, rezulton të jetë 254.6 milionë lekë.

II. Fondi rezervw i zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë

Fondi prej 1 miliardë lekë i planifikuar për përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021, është akorduar me VKM nr.73, datë 9.02.2021 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar në KQZ, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021", të ndryshuar.

III. Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit

Ky fond, i planifikuar në masën 4.5 miliard lekë, deri me datë 31.12.2021 nuk është përdorur.